

Dalja-izlirja

Nr. IV-685
Br.

Data 07.10.2022
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE ZHVILLIM

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

**RAPORT
(PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMET PËR VITET
2024-2025)**

Kryesuesja e Kuvendit Komunal përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim më datë 16.09.2022 ka mbajtur diskutimin publik: “Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitet 2024-2025” Diskutimi është mbajtur në sallën e kuvendit nga ora 14:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent Vlora Mjekiqi Kabashi – kryesuese e kuvendit, Zarife Behluli – drejtore e EFZH-së dhe pjesëtarë të tjerë të ekzekutivit komunal.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 43 qytetarë, prej tyre 19 gra dhe 24 burra.

Kryesuese e kuvendit Vlora Mjekiqi Kabashi, shpalosi buxhetin në vija të trasha.

Buxheti i komunës së Obiliqit për vitin 2023 është: 12,921,229.00 euro i ndarë në 5 kategori ekonomike:

- Paga dhe dhe shtesa – 4,500,000.00
- Mallra dhe shërbime – 1,550,000.00
- Shpenzimet komunale – 380,000.00
- Subvencionet dhe transferet – 1,000,000.00
- Shpenzimet kapitale – 5,491,229.00

Pas prezantimit të Planifikimit të buxhetit për vitin 2023 dhe planifikimit për vitet 2023 dhe 2024, kemi pranuar këto kërkesa nga qytetarët:

- Xhemile Krasniqi – Dua ta di se sa mund të ndihmohet bletaria dhe a kanë ndonjë përkrahje gratë që merren me ushqime tradicionale?
- Zarife Behluli – Drejtoria e bujqësisë vazhdimisht ka përkrahur qytetarët me subvencione në bletari, ndërsa sa i përket kërkesave specifike ju lutem drejtoni në drejtorinë e bujqësisë. Ndërsa subvencione për gra në biznes për vitin 2023 nuk kemi paraparë buxhet.
- Sa i përket subvencionimit të bletarisë kemi shumë kërkesa dhe janë të parapara në vitin 2023 dhe kërkesat duhet të drejtohen në drejtorinë e bujqësisë. Xhemile Krasniqi - Kam bërë kërkesën në bujqësi para një muaji.
- ✓ Zarife Behluli – Kërkesa juaj mund të merret parasysh për vitin 2023, për më shumë informata ju njofton Drejtori i Bujqësisë.
- ✓ Bejtullah Mjekiqi - Sa i përket kërkesës së zonjës, ka shumë dëme në bletari por ne nuk kemi mundësi t'i mbulojmë të gjitha edhe pse e kemi përkrahur çdo vit po për këtë vit nuk kemi buxhet.
- Hyl Berisha - Problemi që dua ta ndaj me ju është ujitja e fushave dhe arave. Unë jetoj në Mazgit dhe jam kontributdhënës që 5 vite në Ibër Lepenc dhe ne nuk mund ta shfrytëzojmë ujin kur me një ndërhyrje shumë të vogël mund ta zgjerojmë ujitjen.
- ✓ Bejtullah Mjekiqi - Sa i përket ujitjes këtë vit e kemi një marrëveshje me Ibër Lepencin ku do të paguhet çdo ari tokë që është ujitur. Në Mazgit te sistemi i Ibër Lepencit kërkesa duhet të drejtohet te Ibër Lepenci, por a mund të ma sqaroni më mirë çështjen?

- Hyl Berisha - Është pjesë e Ibër Lepencit, janë disa rrjeta që janë të vdekura, mua më duhet me u zgjeru ajo pjesë që mos ta shfrytëzoj ujësjellësin për ujitje por rrjedhën e Ibër Lepencit.
- ✓ Bejtullah Mjekiqi - Të bëni kërkesën në komunë ose Ibër Lepenc, dhe nëse ekziston mundësia e zgjerimit unë besoj që Ibër Lepenci janë të gatshëm të na ndihmojnë. Ne këtë vit kemi filluar me sistemin për ujitje dhe kemi marrëveshje me Ibër Lepencin për tri vitet e ardhshme.
- Zelushe Kelmendi - Nga organizata qendra rinore, unë kam një kërkesë, përderisa jam pjesë e dy forumeve të sigurisë të komunës ne kemi nevojë për mjete financiare që të funksionojmë dhe të realizohen këto projekte të KKSB-së. Prandaj kërkoj të parashihet një buxhet i caktuar.
- ✓ Zarife Behluli - Drejtoria për kulturë, rini dhe sport ka buxhet të planifikuar për projekte të OJQ-ve ku ju mund të aplikoni në shpallje publike.

- Ramadan Qunaku - Pse në web faqe të komunës te drejtoritë, asnjë raport nuk e lexoj asnjëherë pse nuk bëhen këto raporte asnjëherë? Jam i interesuar sidomos për drejtorinë e kulturës, pasi që punët po kryhen pse nuk ka raporte?
- ✓ Kryesuesja e Kuvendit - Të gjithë drejtoritë komunale janë të obliguara të dorëzojnë raportin 6 mujor te kryetari. Gjithashtu raporti 6 mujor shqyrtohet në kuvend për të gjitha punët e drejtorive.
- ✓ Arba Mirena - Realisht drejtoria e kulturës i publikon raportet në web faqe, mirëpo nëse zotëria është aktiv në rrjetet sociale mund ti shihni të gjitha punët aty.
- ✓ Zarife Behluli - Përpos raportit të drejtorive të tjera, drejtoria e financave çdo 3 muaj bën raportin financiar të shpenzimeve në periudha tre mujore dhe publikohet në web faqen zyrtare te komunës.
- Hysni Dedinca - Unë desha të pyes, deri ku jeni në procedura të koogjenerimit?
- ✓ Fatmir Bërbatovci - Ne kemi filluar me procedura të tenderimit të koogjenerimit, ky projekt është tre vjeçar ku vlera e këtij projekti për tri vite(përfshirë eshe vitin 2022) është rreth 11,800,000.00€
- Hysni Dedinca - Në cilat zona fillon shtrirja e rrjetit të koogjenerimit?
- ✓ Fatmir Bërbatovci - Në pjesën e parë vetëm zona e qytetit me rrethinë, faza e parë e projektit përfshirë qytetin e Obiliqit fshatin Milloshevë dhe Dardhishtë.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 14:35.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
16.09.2022



Zyrtari përgjegjës për konsultime publike

Festina Preniqi, Flaka Hashani